Kronikë

Lezhë/ I ngacmoi të dashurën në plazhin e Tales, 30 vjeçari qëllon me pistoletë pushuesin, arrestohet pas disa orësh (EMRAT)

Një person është plagosur me armë zjarri në Tale të Lezhës. Ngjarja ka ndodhur pas një konflikti të çastit mes dy personave, për motive shelozie.

HOROSKOPI

Lajmi i fundit

'Tipologji e re e turizmit në Shqipëri', eksperti: Vijnë shumë të rinj! Jo për plazhe por për ture, Gjirokastra nga më të preferuarit

22 Korrik, 22:13

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Elvis Hila
31 Korrik, 14:20 | Përditësimi: 21 Korrik, 20:06

Share

LEZHË- Një plagosje me armë zjarri u shënua mesditën e kësaj të diele, (21 korrik 2024), afër një lokali në plazhin e Tales, në Lezhë, për motive shelozie. Një 30 vjeçar plagosi me armë zjarri 27 vjecarin Alfred Marku, pasi ky i fundit dyshohet se i ngacmoi të dashurën.

Ngjarja u shënua rreth orës 13:30, afër një lokali në breg të detit, në një zonë larg pushuesve në plazhin Tale.

Dy të rinjtë debatuan fillimisht me njëri tjetrin, e më pas autori mori pistoletën dhe qëlloi Alfred Markun. Ky i fundit ndodhet në spitalin e Traumës në Tiranë, aty ku po merr mjekim të specializuar, dhe fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Sh.com
LEXO EDHE:
'Plazhet e Lezhës janë në kapacitete absolute', nënkryetari i bashkisë për Studio Live: Sfidoj këdo, nga portalet nuk merret vesh e vërteta

Policia e Lezhës identifikoi autorin, i cili u largua menjëherë nga vendi i ngjarjes. Në hyrje dalje të qytetit u ngritën pika kontrolli, e brenda pak oresh u bë e mundur lokalizimi dhe prangosja e autorit.

Ai është 30 vjeçari Ermir Lucaj, ndërsa policia gjeti dhe sekuestroi ne cilësinë e provës materiale dhe armën e zjarrit pistoletë me të cilën kreu plagosjen, si dhe automjetin tip Audi që u largua. Grupi hetimor gjithashtu ka sekuestruar në vendngjarje celularin e autorit të dyshuar dhe prova të tjera që do t'i shërbejnë hetimit për dokumentimin ligjor të këtij rasti.

> *Arrestimi i Ermir Lucaj u bë pasi rreth orës 13:30, në një zonë larg pushuesve në plazhin Tale, dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta (motive shelozie), ky shtetas ka plaosur me armë zjarri shtetasin A.M., 27 vjeç, banues në Zejmen, Lezhë.", thotë policia.*

Të dy si i arrestuari Ermir Lucaj 30 vjeç, banues në Rrillë, Lezhë dhe i plagosuri Alfred Marku27 vjeç, banues në Zejmen, të Lezhës ndodhesḧin në plazhin e Tales si pushues.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:19

Plagosi me armë zjarri 27 vjeçarin se i ngacmoi të dashurën, arrestohet autori (EMRI)

Policia ka vënë në pranga autorin e plagosjes me armë zjarri ditën e sotme në plazhin Tale të Lezhës.

U vu në pranga 30 vjeçari Ermir Lucaj, i cili plagosi Alfred Markun 27 vjeç, për motive shelozie, pasi ky i fundit i ngacmoi të dashurën.

> *"Specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit E. L, 30 vjeç, banues në Rrillë, Lezhë.*
>
> *Arrestimi i tij u bë pasi rreth orës 13:30, në një zonë larg pushuesve në plazhin Tale, dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta (motive shelozie), ky shtetas ka plaosur me armë zjarri shtetasin A.M., 27 vjeç, banues në Zejmen, Lezhë.*
>
> *30 vjeçari pasi kreu plagosjen, u largua me një automjet në drejtim të autostradës, por brenda pak orëve u vu në pranga.", njofton policia.*

G.K/Shqiptarja.com

Share

Sl.E./S.G/Shqiptarja.com

TAGS: lale Alfred Marku Lezhë le shtena me arme plagosje Ermir Lucaj

Komento

Komente

Sotir: 21/07/2024 17:56
Bravo mire ja ka ber pleres
Përgjigju

Sondazhi: 21/07/2024 21:51
Bravo them dhe une po kjo pistoleta është bërë sikur po mban çakmak, policia qe duam.

Tutu: 21/07/2024 15:46
I lumte dora.. dava legenesh shqetesijne njerzit kur pushojne...
Përgjigju

Sitir: 21/07/2024 17:58
Bravo

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sh.com
Sondazhi i ditës:
'Rasti Qefalia', a fshihen gjobat pas akuzave të Këlliçit, Nokës, opozitës?
Po Jo Ndoshta

Lajme të tjera

E rëndë në Lezhë, dy 19-vjeçarë marrin peng të mituriin dhe e ngacmojnë seksualisht! E detyruan të përdorë fjalë fyese live në TikTok! Vihen në pranga
22 Korrik, 20:00

33 vjeçari lezhjan prej 15 vitesh kuzhinier: Profesioni më i kërkuar dhe më i paguar
Elvis Hila
21 Korrik, 17:52

Lezhë/ I armatosur me armë zjarri dhe me dy mina me telekomandë, vihet në pranga 48-vjeçari! Do bashkëpunonte për të kryer ngjarje kriminale
21 Korrik, 13:22

Digjet makina në aksin rrugor Laç-Fushë Krujë
20 Korrik, 15:07

I nxehtë ekstrem, por në Blinisht të Lezhës 300 familje pa ujë! Bashkia: E shpërdoroni për vaditje
Elvis Hila
20 Korrik, 12:35

Të panjohurat e Lezhës! 10 udhëtërëfyesit e parë gati për turistët
Elvis Hila
19 Korrik, 15:42

Lezhë/ Aksidenti i frikshëm në superstradë, përplasen 2 makina! Njëra përfundon në parkingun e lokalit e dëmton ë të tjera
18 Korrik, 22:43

Shkëlqen në çdo vend që preki! 15-vjeçarja e talentuar koncert recital në Lezhë
Elvis Hila
18 Korrik, 16:05

Mirditë, u kap duke vaditur parcelën me 520 rrënjë kanabis, në pranga 37-vjeçari (EMRI+VIDEO)
18 Korrik, 10:47

Zjarri në masivin pyjor mes Kurbinit dhe Matit, digjet një bangesë! Ndërhyhet nga ajri për të shuar flakët
16 Korrik, 16:45

Zjarr në magazinat ushqimore në Fushë-Gjorem (VIDEO)
16 Korrik, 10:17

Arrestohet ish oficeri i policisë së Lezhës, ishte në kërkim pasi lejoi kultivimin e kanabisit në 2022 në Ungrej
15 Korrik, 16:10

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje